



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
GRUPI I PUNËS

Nr. 12764 prot.

Tiranë, më 29.6.2022

MEMO

**LËNDA:** Në lidhje me Urdhrin nr. 207, datë 16.11.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për negociimin e saktësimin dhe/ose ndryshimin e kontratës së koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019 "Për shërbimin e kontrollit, ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave të shpërndarjes të karburantit dhe gazit të lëngshëm"

**Drejtuar :** Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë

**Për dijeni:** Z. Arlind GJOKUTA, Sekretar i Përgjithshëm

**Konceptoi:** Grupi i Punës

*E nderuar Znj. Ministre,*

Me anë të kësaj memoje Ju përcjellim raportin e grupit të punës të ngritur me Urdhërin nr. 207, datë 16.11.2021, me objekt "Për ngritjen e grupit të punës për negociimin e saktësimin dhe/ose ndryshimin e kontratës së koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019 "Për shërbimin e kontrollit, ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave të shpërndarjes të karburantit dhe gazit të lëngshëm". Grupi i punës në zbatim të pikës 2 të Urdhrit të sipër cituat është këshilluar nga 2 (dy) përfaqësues të Avokaturës së Shtetit. Gjithashtu është asistuar edhe nga 1 (një) ekspert i ISHMT-së si dhe 1 (një) ekspert i DPM. Qëndrimet e përfaqësuesve të Avokaturës së Shtetit dhe ekspertëve të ISHMT-së dhe DPM i gjeni bashkëngjitur këtij material.

Duke ju falënderuar,



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
GRUPI I PUNËS

Nr. 12764 prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

MEMO

**LËNDA:** Në lidhje me Urdhrin nr. 207, datë 16.11.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për negociimin e saktësimin dhe/ose ndryshimin e kontratës së koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019 "Për shërbimin e kontrollit, ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave të shpërndarjes të karburantit dhe gazit të lëngshëm"

**Drejtuar :** Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë

**Për dijeni:** Z. Arlind GJOKUTA, Sekretar i Përgjithshëm

**Konceptoi:** Grupi i Punës

*E nderuar Znj. Ministre,*

Me anë të kësaj memoje Ju përciellim raportin e grupit të punës të ngritur me Urdhërin nr. 207, datë 16.11.2021, me objekt "Për ngritjen e grupit të punës për negociimin e saktësimin dhe/ose ndryshimin e kontratës së koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019 "Për shërbimin e kontrollit, ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave të shpërndarjes të karburantit dhe gazit të lëngshëm". Grupi i punës në zbatim të pikës 2 të Urdhrit të sipër cituat është këshilluar nga 2 (dy) përfaqësues të Avokaturës së Shtetit. Gjithashtu është asistuar edhe nga 1 (një) ekspert i ISHMT-së si dhe 1 (një) ekspert i DPM. Qëndrimet e përfaqësuesve të Avokaturës së Shtetit dhe ekspertëve të ISHMT-së dhe DPM i gjeni bashkëngjitur këtj material.

Duke ju falënderuar,

## RAPORT

Me anë të këtij raporti Ju informojmë në lidhje me zbatimin me Urdhërin nr. 207, datë 16.11.2021, me objekt "Për ngritjen e grupit të punës për negocimin e saktësimit dhe/ose ndryshimin e kontratës së koncesionit nr. 15326, datë 21.08.2019 "Për shërbimin e kontrollit, ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave të shpërndarjes të karburantit dhe gazit të lëngshëm"

Grupi i punës pasi u njoh me Urdhrin e sipërcituar, në zbatim të tij mori në shqyrtim kërkesat që shoqëria koncesionare "Noa Inspect" sh.p.k ka përcjellë mbi detyrimin kontraktor të MFE-së për saktësimin e kontratës koncesionare nëpërmjet amendimit të saj, për të adresuar ndryshimet e nevojshme të kontratës koncesionare për të gjitha çështjet dhe kërkesat e paraqitura nga Shoqëria Koncesionare në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe parashikimeve të kontratës koncesionare. Konkretisht shkresa me nr. 90 prot., datë 04.08.2020, protokolluar me tonën nr. 14757 datë 04.08.2020; shkresa me nr. 07 prot., datë 21.01.2021 hyrë në MFE me nr. 1209 prot., datë 21.01.2021, shkresa me nr. 09 prot., datë 26.01.2021 hyrë në MFE me nr. 1541 prot., datë 26.01.2021 dhe shkresës nr. 109 prot., datë 29.10.2021 hyrë në MFE me nr. 18993 prot., datë 29.10.2021. Gjithashtu shkresën nr. 14757/1 prot., datë 03.09.2020 të Autoriteti Kontraktues, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka kthyer përgjigje Shoqërisë Koncesionare si me poshtë: "Amendimi i kontratës së koncesionit është i lidhur ngushtësisht me miratimin e projektligjit "Për Metrologjinë" i cili aktualisht ndodhet në proces miratimi në Kuvend. Ndodhur para këtij fakti vetëm pas miratimit në Kuvend të këtij projektligji, mund të adresohen kërkesat tuaja për sakësimin e kontratës nëpërmjet amendimit të saj".


Pas shqyrtimit të dokumentacionit Grupi i Punës zhvilloj takimin e parë datë 15.12.2021, ora 12:00 me shoqërinë koncesionare për të dëgjuar dhe diskutuar mbi pretendimet e ngritura nga këta të fundit. Noa Inspect sh.p.k ka cituar se me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr.126/2020 "Për metrologjinë", (publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 222 datë 18.12.2020 dhe hyrë në fuqi më datë 03.01.2021) ka lindur nevoja e amendimit të disa neneve të Kontratës së Koncesionit, me qëllim reflektimin e ndryshimeve ligjore, qartësimin e parashikimeve kontraktuale dhe të përshtatjes së Kontratës së Koncesionit sipas legjislacionit në fuqi, konkretisht çështjet që duhen saktësuar në Kontratën e Koncesionit, si më poshtë vijon:

### **1) Parapagimi i tarifave të shërbimit objekt koncesioni**

Në Nenin 53, ligji nr.126/2020 në fuqi aktualisht ka parashikuar që faturimi i shërbimeve objekt i koncesionit të kryhet me parapagim. Aktualisht, një detyrim i tillë nuk ndodh, pra parapagimi nuk realizohet, duke kushtëzuar kryerjen e Shërbimit të ofruar nga Shoqëria Koncesionare sipas vullnetit të subjekteve të detyruara. Rrjedhimisht, një gjë e tillë, përveç faktit që është një shkelje e një detyrimi të parashikuar shprehimisht në ligj, jo vetëm që pengon realizimin e të ardhurave që Shoqëria Koncesionare merr nga ofrimi i këtij Shërbimi, por ndikon po ashtu drejtpërdrejtë në tarifën koncesionare që mbledh shteti shqiptar si rezultat i këtij Shërbimi, pra krijon efekte negative për të dy Palët Kontraktore.

### **2) Saktësimi i subjekteve ndaj të cilave duhet të kryhet kontrolli ligjor nëpërmjet verifikimit të të gjitha instrumenteve matëse shpërndarëse dhe të gazit të lëngshëm.**

Në nenin 22 të ligjit nr.126/2020 por edhe në Objektin e Kontratës së Koncesionit përcaktohet se 'të gjitha instrumentet matëse ligjorisht të kontrolluara që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, i nënshtrohen verifikimit të kontrollit ligjor'. Pra



ese përdorim terminologjinë tatimore, kjo nënkupton që subjektet e detyruara që duhet t'i nënshtrohen këtij Shërbimi janë si subjektet e shumicës dhe ato të pakicës. Në gjykimin tonë, një saktësim i tillë i shërben jo vetëm funksionimit ligjor, por gjithashtu zgjidh një ngërç në fushën e hidrokarbureve, pasi pikat e shumicës nuk janë të kontrolluara as nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe as nga Shoqëria Koncesionare 'NOA Inspect' sh.p.k, duke operuar kështu në shkelje të ligjit dhe duke kontribuar në evazionin fiskal.

### 3) *Rritja e frekuencës së shërbimit*

Neni 22, pika 1, e ligjit nr.126/2020, përcakton se "në varësi të analizës së riskut dhe problematikave të tregut, por në çdo rast jo më pak se 5%, periodiciteti i verifikimeve të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluara do të dyfishohet". Faktikisht duke u nisur nga situata reale në terren dhe duke iu referuar raportimeve të vazhdueshme nga ana Shoqërisë Koncesionare, është evidentuar se përqindja e instrumenteve ngelëse ka rezultuar disa herë më e lartë se sa treguesi prej 5%. Rezervojmë të drejtën që propozimet përkatëse për këtë çështje t'ju paraqesim në momentin e realizimit të amendimit të Kontratës së Koncesionit.

### 4) *Saktësimi i regjimit automatik*

Në Urdhrin nr.126, datë 21.05.2020 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë "Për kryerjen e kontrollit ligjor dhe sigurimit të regjimit automatik të instrumenteve matës", përcaktohet se kontrolli dhe siguri i regjimit automatik do të kryhej nga NOA Inspect sh.p.k. Gjithashtu referuar edhe Nenit 22, pika 1, të ligjit nr.126/2020 ku është përcaktuar se: 'Verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm .... përfshin kontrollin dhe sigurimin e regjimit automatik', është e domosdoshme që reflektimi i plotë i këtij parashikimi të bëhet edhe në Kontratën e Koncesionit, në mënyrë që kjo e fundit të jetë në pajtueshmëri të plotë me detyrimet e ligjit nr.126/2020 si dhe për ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit të Shërbimit.


### 5) *Saktësimi i intervaleve të kalibrimit*

Për qëllime qartësimi dhe shmangien e konfuzionit të palëve, sugjerojmë të saktësohet neni 26, pika 1.2 i Kontratës së Koncesionit në lidhje me frekuencën e kalibrimit të instrumenteve matëse. Meqenëse kalibrimi është shumë i nevojshëm për të ruajtur standardet e saktësisë në matje dhe dispozita e këtij neni nuk rezulton shumë e qartë, sugjerojmë riformulimin e këtij neni që në rast të moskryerjes në mënyrë të përsëritur të kalibrimit për një periudhë 3 (tre) vjeçare, atëherë ky do përbëjë një shkak të ligjshëm për zgjidhjen e parakohshme të njëanshme të Kontratës së Koncesionit nga Autoriteti Kontraktues.

Megjithatë sikurse jeni në dijeni nga raportimet, Koncesionari ka kryer brenda afateve dhe më shpesh se sa është e përcaktuar në Kontratën e Koncesionit kalibrimin e pajisjeve matëse me qëllim sigurimin e cilësisë së Shërbimit. Prandaj saktësimi i këtij neni kërkohet për të siguruar kohezionin dhe pëmbushjen e detyrimeve kontraktuale nga të dyja Palët Kontraktore.

### 6) *Realizimi i gjurmueshmërisë së hidrokarbureve*

Me ndryshimet e reja ligjore të hyra në fuqi në Janar 2021, në nenin 15 'Gjurmueshmëria e njësive të matjes' të ligjit nr.126/2020 "Për metrologjinë", NOA Inspect sh.p.k ka përfituar automatikisht të drejtën e gjurmueshmërisë së hidrokarbureve dhe GLN-së, që nënkupton verifikimin e rezultatit të matjes, me qëllim sigurimin e saktësisë dhe besueshmërisë të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara. Përkatësisht, në Nenin 15 të ligjit nr.126/2020 përcaktohet shprehimisht që: "... Në



astet ku shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga subjekte të autorizuar me një nga format e parashikuara në ligj, gjurmueshmëria realizohet vetëm nga këto subjekte.”

Rrjedhimisht, rezulton që gjurmueshmëria dhe monitorimi në kohë reale i qarkullimit të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm duhet të realizohet vetëm nga subjekte të autorizuar me një nga format e parashikuara në ligj, pra nga Shoqëria Koncesionare, dhe si rrjedhojë ky parashikim duhet të materializohet edhe në praktikë.

Grupi i punës vazhdoi me takimet (bashkëlidhur këtij materjali lutem gjeni dhe minutat e takimit të mbajtura), me qëllim analizimin e 6 (gjashtë) pretendimeve të ngritura nga shoqëria koncesionare në takimin e parë datë 15.12.2021, që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe kontratës koncesionare.

### **Lidhur me kërkesën e Koncesionarit për të saktësuar/amenduar Kontratën e Koncesionit.**

Rezultoi se Koncesionari legjitimohet *ratione materiae* për iniciimin e procesit për saktësimin/negociimin e Kontratës, pasi ekziston një lidhje e domosdoshme mes objektit të Kontratës së Koncesionit dhe ndryshimeve që ka pësuar Ligji 126/2020 “Për Metrologjinë”.

E drejta për të saktësuar/amenduar një kontratë koncesioni buron nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi, përkatësisht:

- Neni 31, pika 2 dhe pika 3/c Ligji nr. 125/2013 “Për Koncesionet/Partneritetin Publik Privat”, i ndryshuar;
- Neni 23 i VKM-së nr. 575, datë 10,07,2013, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat”, i ndryshuar; dhe
- Kontrata e Koncesionit “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave të shpërndarjes të karburantit dhe gazit të lëngshëm” që sanksionon se: “Ndryshim në ligj është ndryshimi i ligjit që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate...” (fq.8 e Kontratës).


Sa më sipër vlerësohet se kërkesa e Koncesionarit për saktësimin/amendimin e Kontratës është në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **➤ Parapagimi i tarifave të shërbimit objekt koncesioni**

Neni 53 “Pagesat dhe tarifave të shërbimeve” i ligjit nr. 126/2020 “Për metrologjinë” ka parashikuar:

“1. Kalibrimi, miratimi i tipit, verifikimi fillestar dhe pasardhës i instrumenteve matëse, miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të parapaketimeve dhe të shisheve si enë matëse, shërbimet e metrologjisë ligjore të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, përfshirë edhe shërbime riparimi, si dhe trajnimet e ofruara kryhen kundrejt tarifave të miratuara nga autoritetet shtetërore përkatëse. Këto tarifa miratohen nga ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për ekonominë ose në një nga format e parashikuara në legjislacionin përkatës. Tarifave janë të njëjta si për subjektet vendase, ashtu edhe për ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë dhe për rastet e shërbimeve, objekt i këtij ligji, ato parapagohen nga subjektet përkatëse. Mënyra dhe afatet e parapagimit të këtyre tarifave përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe personat juridikë privatë, të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i këtij ligji, si edhe laboratorët e etaloneve kombëtare, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për kryerjen e shërbimeve të ndryshme, përdorin tarifa të miratuara nga ministri



...përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për ekonominë, ose të miratuara me një nga format e parashikuara në legjislacionin përkatës."

#### Vlerësimi i Avokaturës:

"Vlerësojmë se ndryshimi i parashikuar në ligj që lidhet me parapagimin, do të jetë i aplikueshëm me miratimin e Udhëzimit përkatës të parashikuar nga neni 53 pika 1.

Për sa parashikohet në nenin 53 të ligjit, Udhëzimi për parapagimin do të përcaktonte mënyrën dhe afatet e parapagimit, ndërsa tarifat e shërbimit do të përcaktohen me urdhër Ministri, zgjidhja e diskutuar me një akt të përbashkët është çështje e Drejtorisë së Hartimit të legjislacionit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Lidhur me propozimin e shoqërisë për reflektimin e këtij parashikimi në kontratën koncesionare, vlerësojmë se nuk është i nevojshëm ndryshimi i kontratës për sa kohë ky parashikim do të bëhet i zbatueshëm me miratimin e udhëzimit përkatës."

Qendrimi i Grupit të Punës referuar sa më sipër, duke qenë se objekti i veprimtarisë së shoqërisë koncesionare është pjesë e këtij ligji, lind nevoja që në zbatim dhe të parashikimit të mësipërm ligjor shërbimi i ofruar nga shoqëria koncesionare të parapaguhet. Përsa i përket mënyrës dhe afateve të parapagimit, ato duhet të përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë që duhet të dalë në zbatim të ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjinë".

#### ➤ Saktësimi i subjekteve ndaj të cilave duhet të kryhet kontrolli ligjor nëpërmjet verifikimit të të gjitha instrumenteve matëse shpërndarëse dhe të gazit të lëngshëm.


Nenin 22 të ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjinë" por edhe në Objektin e Kontratës së Koncesionit përcaktohet se 'të gjitha instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara që kanë marrë miratimin e tipit dhe plotësojnë kërkesat teknike dhe metrologjike, i nënshtrohen verifikimit të kontrollit ligjor'

Nga takimet e zhvilluara me anëtarët e grupit të punës, përfaqësuesit e ISHMT janë shprehur se klasifikimi i instrumentave që përdoren në këtë fushë bëhet sipas parametrin (Qmax) prurja dhe jo sipas emërimit të subjektit që ka në përdorim instrumentin, ndërsa DPM nëpërmjet anëtarit në grupin e punës është shprehur se këtë shërbim e ofron DPM-ja dhe ka investuar në gjithë infrastrukturën e nevojshme për ta kryer si shërbim.

Nëse shërbimi i verifikimit të instrumentave matës për shumicën që aktualisht kryhet nga DPM-ja, do të kalonte shoqërisë koncesionare, në kuptim të nenit 33 të ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar, me qëllim që nga ana e grupit të punës të kryhet një analizë nëse dhenia e këtij shërbimi shtesë përbën më shumë ose jo të 30% të vlerës së kontratës bazë, Grupi i Punës ka kërkuar nga ana e shoqërisë koncesionare dhe DPM-së në cilësinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e këtij shërbimi aktualisht, të paraqitet një studim me të gjithë elementët ekonomikë dhe financiarë të kësaj shtesë.

Shoqëria koncesionare ka përciell këtë dokumentacion me anë të shkresës nr. 22 prot., datë 09.02.2022, protokolluar me tonën nr. 2710, datë 11.02.2022, nga i cili rezulton se propozimi i shoqërisë koncesionare nuk përbën më shumë se 30% të vlerës së kontratës bazë. Me anë të shkresës së sipërcituar shoqëria koncesionare shprehet si më poshtë vijon:

Aktualisht në Republikën e Shqipërisë operojnë 38 subjekte me shumicë, ku në total ndoshen 105 kontralitra, prej të cilave 87 janë kontralitra me prurje mn 1000 l/min dhe 18 janë



kontralitra me prurje nën 1000 l/min. Noa Inspekt deklaroi se ka kryer investimet e nevojshme dhe ka akreditimin e duhur për ofrimin e këtij shërbimi, por citon se do të vazhdojë të procedojë me investimet e tjera si mastermetrin e gazit LPG dhe paisjeve shtesë. Vlera e investimit nuk i kalon 30% të vlerës totale të investimit të kontratës së koncesionit, sipas nenit 33, të ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet/PPP", i ndryshuar.

Pajisje	Vlera në Lekë me TVSH
Etaloni 2000 L	2,223,700
Makina që përdoren për lëvizjen e enës (Karroceria)	527,754
<b>Totali</b>	<b>2,751,454</b>

Nga ana e DPM-së akoma nuk është depozituar ndonjë dokumentacion shterues për këtë pikë por vetëm një informacion mbi verifikimin e kontralitrave dhe investimin e kryer për ofrimin e këtij shërbimi. Nga ky informacion DPM deklaroi se shërbimi i kontrollit metrologjik ligjor të shpërndarësve të karburantit (kontralitrat e mëdhenj) në pikat e tregëtimit me shumicë të karburanteve dhe shpërndarësve të përdorur në produktet ushqimore siç janë birra, pijet alkoolike kryhet prej tyre. Investimet e bëra për kryerjen e këtyre shërbimeve janë si në tabelën më poshtë:

Pajisje	Vlera në Lekë
Enë volumore standarte 2000 L	4,856,000
Enë volumore standarte 5000 L	8,640,000
Instrument matës ultra sonik	1,422,000
Ene metalike 200 L + c. kalibrim	715,932
Aparat volume 30 ItEartman CH 89	1,991,600
Makina që përdoren për tërheqjen e enëve volumore	3,600,000
Automjet për pajisjet e testimit të LPG	3,225,600
<b>Total</b>	<b>24,801,132</b>

Referuar informacionit të DPD numri i kontralitrave të verifikuar në një vit kalendarik është 267, në 88 subjekte ku 227 kontralitra janë në pika të tregëtimit të karburanteve dhe 40 kontralitra të përdorur për produktet ushqimore si birrë, pije alkoolike dhe qumësht. Nga ky informacion nuk del e qarë se sa është investimi për sektorin e hidrokarbureve pasi këto paisje përdoren edhe për produktet ushqimore.

#### Vlerësimi i Avokaturës së Shtetit:

*"Referuar parashikimeve të nenit 22 të ligjit është e papërcaktuar në mënyrë eksplicite nëse në të gjithë instrumentet përfshihen pikat e pakicës apo dhe ato të shumicës.*

*Referuar nenit 3 të kontratës së koncesionit: "Objekt i koncesionit është kryerja nga koncesionari i shërbimit të kontrollit ligjor të instrumentave matëse nëpërmjet verifikimit të*

strumentave shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm të naftës në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë (referuar si "Shërbimi" ose "Projekti").

Githashtu, në objektin e sipërcituar, sërish nuk është e qartë nëse në të gjithë instrumentet përfshihen pikat e pakicës apo dhe ato të shumicës. Duhet mbajtur parasysh se ky nen referon te "Shërbimi", "Projekti", të cilin nuk i disponojmë. Sugjerojmë të vlerësoni nëse dhënia me koncesion ka përfshirë dhe pikat e shumicës sipas projektit të pranuar nga AK, referuar dhe diskutimit në takimin e zhvilluar me grupin e punës ku aktualisht pikat e shumicës kontrollohen nga DPM.

Sa më sipër duke qenë se parashikimi ligjor në nenin 22 të ligjit dhe objekti i kontratës së koncesionit përdorin të njëjtën terminologji "të gjithë instrumentet matëse" duke mos përcaktuar qartë nëse përfshihen edhe pikat e shumicës, vlerësojmë se propozimi i kërkuar nga shoqëria për ndryshim të kontratës koncesionare nuk vjen si pasojë e hyrjes në fuqi të ligjit të ri 126/2020 për sa kohë nuk ka sjellë ndryshime lidhur me këtë pikë."

Për sa më sipër, Grupi i Punës ka konstatuar të drejtën ligjore për të kërkuar saktësimin e subjekteve ndaj të cilave duhet të kryhet kontrolli ligjor nëpërmjet verifikimit të të gjitha instrumenteve matëse shpërndarëse dhe të gazit të lëngshëm dhe referuar dokumentacionit të shoqëris koncesionare si dhe vlera e investimit nuk i kalon 30% të vlerës totale të investimit të kontratës së koncesionit, sipas nenit 33, të ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet/PPP", i ndryshuar.

#### ➤ Rritja e frekuencës së shërbimit

Lidhur me këtë pikë neni 22, pika 1, e ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjin", përcakton se "...në varësi të analizës së riskut dhe problematikave të tregut, por në çdo rast jo më pak se 5%, periodiciteti i verifikimeve të instrumenteve matës ligjorisht të kontrolluara do të dyfishohet". Faktikisht duke u nisur nga situata reale në terren dhe duke iu referuar raportimeve të vazhdueshme nga ana Shoqërisë Koncesionare, është evidentuar se përqindja e instrumenteve ngelëse ka rezultuar disa herë më e lartë se sa treguesi prej 5%. Rezervojmë të drejtën që propozimet përkatëse për këtë çështje t'ju parashtrijmë në momentin e realizimit të amendimit të Kontratës së Koncesionit."

Gjatë takimeve të zhvilluara me grupin e punës, eksperti i ISHMT është shprehur se Ligji nr. 126/2020 "Për Metrologjin", neni 22, pika 1 ka në konsideratë një tip, model të caktuar instrumenti në një fushë të caktuar, i cili shfaq defekte (nuk garanton ruajtjen e karakteristikave metrologjike) midis dy frekuencave të një pas njëshme të verifikimit. Pra rrjedhimisht nuk bëhet fjalë për të gjithë instrumentet e një fushe, por vetëm për tipin për të cilin është dokumentuar defekti. Grupi i punës ka kërkuar nga shoqëria koncesionare dokumeta shteruese për këtë çështje. Shoqëria koncesionare me anë të shkresës nr. 22 prot., datë 09.02.2022, protokolluar me tonën me nr. 2710, datë 11.02.2022, ku janë paraqitur të dhënat në lidhje me instrumentat matës jashtë parametrave metrologjike për vitin 2021, me numër dhe përqindje që zënë për secilin tip/model shpërndarësi. Nga kjo tabel rezultonë që është kufiri minimal ligjor është pesëfish më i madh se ai që parashikohet nga kuadri ligjor, përkaësisht nga pika 1 e nenit 22 të ligjit nr. 126/2022 "Për metrologjin".

Vlerësimi i Avokaturës së Shtetit:

...nëse ky afati është i arsyeshëm për të ruajtur standartet e saktësisë në matje."

Qëndrimi i Grupit të Punës: Nga diskutimet e grupit të punës, përfaqësuesit e DPM janë shprehur se intervalet e kalibrimit të këtyre instrumentave janë 3- vjecare, kështu që qartësimi i kësaj pike në kontratë bën sens dhe pretendimi i shoqërisë koncesionare lidhur me kalibrimin mund të saktësohet në kontratë.

➤ Realizimi i gjurmueshmërisë së hidrokarbureve

Në nenin 15 'Gjurmueshmëria e njësive të matjes' të ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjinë" ku citohet se "Transmetimi i njësive të matjeve tek instrumentet matëse sigurohet me anë të kalibrimit ose nëpërmjet përdorimit të materialeve referuese të certifikuara. Në rastet kur shërbimet, objekt i këtij ligji, kryhen nga subjekte të autorizuar me një nga format e parashikuara në ligj, gjurmueshmëria realizohet vetëm nga këto subjekte".

Gjithashtu referuar shkresës së DPM-së nr. 143/1 prot., datë 01.02.2021, protokolluar me tonën nr. 1541/1, datë 04.02.2021, ku është përgjigjur kërkesës së shoqërisë koncesionare në Platformën e Bashkëqeverisjes (çështjes nr. 327881, datë 26.01.2021) ku citohet se:

".... Rrjedhimisht, meqenës kategoria e shërbimit të kontrollit ligjor të instrumentave matës të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, i është dhënë subjektit në fjalë, me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi, atëher këtij të fundit, në bazë të nenit 15 të Ligjit 126/2020, I takon të bëjë edhe gjurmueshmërinë e të dhënave të matjeve në sektorin e hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm.

E drejta e subjektit për të realizuar gjurmueshmërinë e të dhënave të rezultateve të matjes në sektorin e hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm, buron edhe nga e drejta dhe detyrimi ekskluziv i kësaj të fundit për të siguruar dhe certifikuar regjimin automatik, që përfaqëson regjimin e vetëm, Në të cilin përpunohen dhe transmetohen të dhënat që vijnë nga rezultatet e matjeve në sektorin e hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm".

Nga diskutimet e grupit të punës, përfaqësuesit e DPM-së janë shprehur se gjurmueshmëria sipas përkufizimeve të ligjit për metrologjinë, nënkupton gjurmueshmërinë metrologjike që është cilësia e rezultatit të matjes ose vlera e etalonit të matjes, e arritur nëpërmjet një zinxhiri të pashkëputur të dokumentuar kalibrimesh, ku secili kontribuon në pasigurinë e matjeve dhe nuk ka lidhje me gjurmueshmërinë e pretenduar nga shoqëria koncesionare.

Lidhur me këtë pikë, referuar parashikimeve të ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjinë" rezultojnë se gjurmueshmëria e pajisjeve hidrokarbure duhet të kryhet nga shoqëria koncesionare, por me aq informacion sa disponojmë nuk mund të gjykojmë se si do të realizohet gjurmueshmëria nga shoqëria koncesionare.

Gjithashtu, nëse ky shërbim do të kalonte shoqërisë koncesionare, në kuptim të nenit 33 të ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar, me qëllim që nga ana e Grupit të Punës të kryhet një analizë nëse dhenia e këtij shërbimi shtesë përbën më shumë ose jo të 30% të vlerës së kontratës bazë, Grupi i Punës ka kërkuar nga ana e shoqërisë koncesionare dhe DPM-së në cilësinë e institucionit përgjegjës për ofrimin e këtij shërbimi aktualisht, të paraqitet një studim me të gjithë elementët ekonomikë dhe financiarë të kësaj shtese kontrate.

...shoqëria koncesionare ka përciell këtë dokumentacion me anë të shkresës nr. 22 prot., datë 09.02.2022, protokolluar me tonën nr. 2710, datë 11.02.2022. Sipas legjislacionit në fuqi të gjitha pikat e shitjes të karburanteve (duke filluar nga hallka fillestare e zinxhirit ekonomik të tyre deri tek ajo përfundimtare) duhet të jenë të pajisura me dispenser që veprojnë vetëm në regjim automatic dhe nën kontrollin fiskal të lidhura me një zgjidhje softwerike të certifikuar. Nëpërmjet gjurmueshmërisë së hidrokarbureve, process ky i cili do të mundësoj për DPT, DPD dhe MFE të marri në kohë reale të dhënat e transmetuar nga çdo subjekt i detyruar që operon në fushën e hidrokarbureve dhe gazit të gazit të lëngshëm. Nga një studim paraprak i tregut në fushën e hidrokarbureve nga koncesionari janë si më poshtë:

	Kosto fillestare – Set Up për Stacion Karburanti
Kosto Set Up – POS	2,800.00 Euro
Kosto Set Up – Card Mangement System pa server	3,800.00 Euro
Kosto Set Up – Card Mangement System me server	6,000.00 Euro
Për një stacion karburanti mesatarisht janë në funksion 3 POS	8,400.00 Euro
<b>Kosto Total Set Up (Varianti pa Server CMS)</b>	<b>12,200.00 Euro</b>
<b>Kosto Total Set Up (Varianti me Server CMS)</b>	<b>14,400.00 Euro</b>

	Kosto mirmbajtje mujore për stacion karburanti
Mirëmbajtje për çdo pajisje POS (mesatarisht 3 POS)	120.00 Euro
Qarku i Shiritit të Kontrollit Elektrik	20.00 Euro
Pastrimi i Memories Fiskale	25.00 Euro
Mirëmbajtje Mujore për CMS varianti pa server	200.00 Euro
Mirëmbajtje Mujore për CMS varianti me server	400.00 Euro
<b>Kosto Totale Mirëmbajtje Mujore (Varianti pa server)</b>	<b>365.00 Euro</b>
<b>Kosto Totale Mirëmbajtje Mujore (Varianti me server)</b>	<b>645.00 Euro</b>

Nga ana e DPM-së nuk është depozituar një dokumentacion shterues për të cilin grupi i punës ka kërkuar por në një ndër takimit përfaqësues të DPM kanë paraqitur një dokumentacion me titull "Gjurmueshmëria në matje" ku evidentohet si më poshtë:

"Objekti i ligjit nr. 126/2022, datë 15.10.2022 "Për metrologjinë" ndër të tjera përfshinë edhe bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes në Republikën e Shqipërisë. ... Trasmetimi i njësive të matjeve tek instrumentet matës sigurohet me anë të kalibrimit ose nëpërmjet përdorimit të matjeve referuese të certifikuar. Në rast kur shërbimet, objekti i këtij ligji, kryhen

sa subjekte të autorizuara me një nga format e parashikuara në ligj, gjurmueshmëria realizohet vetëm nga keto subjekte"

Vlerësimi i Avokaturës së Shtetit:

"Vlerësojmë se ndryshimi i propozuar vjen si pasojë e ndryshimeve ligjore të parashikuara në nenin 15 të ligjit 126/2020."

Për sa më sipër, Grupi i Punës ka konstatuar që ligjërisht kërkesa e shoqëris koncesionare për sa i përket realizimit të gjurmueshmërisë së hidrokarbureve është e bazuar në nenin 15 të ligjit 126/2020 "Për metrollojin".

3

~~5~~

Chy

9

Chy

—

12

## KONKLUZIONE

Në përfundim të analizës së mësipërme sjellim në vëmendje se:

Kërkesat e Koncesionarit për saktësim/amendim Kontrate ligjërish janë të mbështetura në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, si më poshtë vijon:

- Neni 31, pika 2 dhe pika 3/c Ligji nr. 125/2013 "Për Koncesionet/Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar;
- Neni 23 i VKM-së nr. 575, datë 10,07,2013, "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat", i ndryshuar; dhe
- Kontrata e Koncesionit "Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumentave të shpërndarjes të karburantit dhe gazit të lëngshëm"

### Konkretisht:

#### 1. Parapagimi i tarifave të shërbimit objekt koncesioni

Duke qenë se objekti i veprimtarisë së shoqërisë koncesionare është pjesë e këtij ligji, lind nevoja që në zbatim dhe të parashkimit të mësipërm ligjor shërbimi i ofruar nga shoqëria koncesionare të parapaguhet. Përsa i përket mënyrës dhe afateve të parapagimit, ato duhet të përcaktohen në udhëzimin e ministrit të financave dhe ekonomisë që duhet të dalë në zbatim të ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjin". Sugjerojmë që në rast vlersëimi nga ana Juaj ky ndryshim duhet të reflektohet në kontratën koncesionare.

#### 2. Saktësimi i subjekteve ndaj të cilave duhet të kryhet kontrolli ligjor nëpërmjet verifikimit të të gjitha instrumenteve matëse shpërndarëse dhe të gazit të lëngshëm.

Konstatohet e drejta ligjore për të kërkuar saktësimin e subjekteve ndaj të cilave duhet të kryhet kontrolli ligjor nëpërmjet verifikimit të të gjitha instrumenteve matëse shpërndarëse dhe të gazit të lëngshëm dhe referuar dokumentacionit të shoqëris koncesionare si dhe vlera e investimit nuk i kalon 30% të vlerës totale të investimit të kontratës së koncesionit, sipas nenit 33, të ligjit nr. 125/2013 "Për Koncesionet/PPP", i ndryshuar. Sugjerojmë që në rast vlersëimi nga ana Juaj ky ndryshim duhet të reflektohet në kontratën koncesionare.

#### 3. Rritja e frekuencës së shërbimit

Nisur nga fakti që ligji për metrologjinë e ka përcaktuar që periodiciteti i verifikimit të instrumentave matës ligjërish të kontrolluar mund të jetë objekt dyfishi edhe për objektin e veprimtarisë së shoqërisë koncesionare duhet të zbatohet ky parashikim. Mënyra dhe forma se si do të realizohet kjo rritje periodiciteti, do të shqyrtohet pas paraqitjes së propozimeve përkatëse nga ana e shoqërisë koncesionare. Sugjerojmë që në rast vlersëimi nga ana Juaj ky ndryshim duhet të reflektohet në kontratën koncesionare.

#### 4. Saktësimi i regjimit automatik

Konstatohet se është e domosdoshme që reflektimi i plotë i këtij parashikimi të bëhet edhe në Kontratën e Koncesionit, në mënyrë që kjo e fundit të jetë në pajtueshmëri të plotë me detyrimet e ligjit nr. 126/2020 "Për metrologjin" si dhe për ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit të Shërbimit.

## Saktësimi i intervaleve të kalibrimit

Përfaqësuesit e DPM janë shprehur se intervalet e kalibrimit të këtyre instrumentave janë 3-vjecare, kështu që qartësimi i kësaj pike në kontratë bën sens dhe pretendimi i shoqërisë koncesionare lidhur me kalibrimin mund të saktësohet në kontratë.

### **6. Realizimi i gjurmueshmërisë së hidrokarbureve**

Grupi i Punës ka konstatuar që ligjërisht kërkesa e shoqëris koncesionare për sa i përket realizimit të gjurmueshmërisë së hidrokarbureve është e bazuar në nenin 15 të ligjit 126/2020 "Për metrollogjin".

Për sa më sipër në vlerësimin Tuaj, duke Ju falënderuar,

### **GRUPI I PUNËS:**

Z. BESART KADIA, Kryetar - Zëvendësministër  
Z. PETRIT RAMA, Anëtar - Drejtor  
Z. LAVRIM SAHITAJ, Anëtar - Drejtor  
ZNJ. INA ZEQAJ, Anëtar - Përgjegjës Sektori  
ZNJ. SILVIA PASKALI, Anëtar - Përgjegjës Sektori  
ZNJ. EDLIRA ABAZI, Anëtar - Specialist  
ZNJ. IRMA LUZI, Anëtar - Specialist

Asistuar nga : Ekspert i ISHMT-së Z. ROLAND BELERI  
Ekspert i DPM-së Z. FRROK COKU  
Përfaqësues nga Avokatura e Shtetit ZNJ. FLORINDA IBRAHIMI  
ZNJ. MEGI METALLA